

**Kreditimi Rural i Kosovës SH.P.K.**, është Institucion Mikrofinanciar i regjistruar në BQK, me mision të ofroj shërbime financiare për klientët me të ardhura të ulëta, me fokus të veçantë për bizneset mikro, të vogla, bujqësore dhe aktivitetet tjera në zonat rurale dhe urbane, me fokus prioriteti në bujqësi dhe një vëmendje të veçantë për qëndrueshmërinë financiare, sociale dhe mjedisore.

Kreditimi Rural i Kosovës Sh.p.k shpall:

## K O N K U R S

Për rekrutim të **Një (1) Nepunes-e për kontrolle interne (junior)** për zyrën qendrore në **Prishtinë**, me kontratë 6 (gjashtë) mujore me mundësi vazhdimi.

### Përgjegjësitë:

- Ben kontrollimin e fajllave kreditor në të gjithë portfolion e KRK-se.
- Kontrollon teresinë dhe saktësinë e të gjitha dokumenteve të nevojshme në dosjet e kredite dhe dokumentacionit tjetër duke përfshirë kontrollimin e nënshkrimeve, miratimet, vlefshmerinë e dokumenteve etj.
- Ben vlerësimin e bizneseve të klienteve në baze të të dhënave të ofruara në formularet e analizës së aplikimit për kredi.
- Ben vizita tek huamarrsit përfundimtare në deget e KRK-se për të verifikuar nëse informacioni i paraqitur në dosjet të kreditit mbi biznesin/karakterin e klientit korrespondon me realitetin.
- Pergadite analiza të pavaruara dhe informata të tjera që mund të kerkohen nga menaxhmenti.
- Pergadite raporte përmbledhese duke dhënë rekomandime për korigjim (përmirësim) të mangësive të gjetura.
- Siguron zbatimin e politikave dhe procedurave të rishikimit të kredive.
- Raporton në lidhje me shkeljet e politikave dhe procedurat nga stafi i KRK-se në nivel dege dhe veprime të ndermarra nga drejtuesit e degës/ oficeret e kredite për të eliminuar mangësitë e konstatuara.
- Pune të tjera të nderlidhura me departamentin e rrezikut dhe kontrolles interne.

### Kushtet e kërkuesit:

- Diplomë universitare në ekonomi (e preferueshme),
- Njohuri mbi procesin e kreditimit dhe dokumentimit,
- Përvojë paraprake në punë të ngjajshme (e preferueshme),
- Njohuri të mira të punës me kompjuter, të njoh Microsoft Office dhe punën me baza të të dhënave,
- Shkathtësi të mira të komunikimit verbale dhe me shkrim, si dhe shkathtësi të përpilimit të raporteve me shkrim.
- Të jete dinamik, të ketë fleksibilitet, kreativ dhe i gatshëm për punë në ekip,
- Njohuri të gjuhës angleze (e preferueshme),
- Të posedoj patentë shofer për kategorinë B.

Konkursi mbetet i hapur nga dt. **09.08.2022** deri me dt. **14.08.2022**. Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë vetëm duke plotësuar aplikacionin në linkun: <http://krk-ks.com/vendepune/job-list?id=780>

**Vetëm një numër i përzgjedhur i kandidatëve do të ftohet në intervistë.**

*KRK ofron zëvillim profesional dhe pakë konkurruese të kompensimit në përputhje me përgjegjësitë dhe përvojën.*

Kreditimi Rural i Kosovës është i perkushtuar të ofroj mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës.